

ANKËS NË ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Administrata Tatimore e Kosovës**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **1600-25-4483-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së (tenderi është i ndarë në 4 pjesë)**

Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Gani B. Krasniqi B.I.D.P.Z "Suzuki"

Adresa e plotë: Miradi e Ulët- Fushë Kosovë

Numri Telefonit: + 383 45 388 484

Kodi postar: 12000

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë: Gani Krasniqi

Adresa elektronike: suzuki_gk@hotmail.com

Data e parashtrimit të kërkesës: 04.09.2026



3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

- Njoftimi për kontratë në E-Prokurim: 21.05.2025;
- Lloji i procedurës së aplikuar: Procedurë e hapur;
- Lloji i kontratës së publikuar: Kontratë publike kornizë shërbime;
- Vlera e parashikuar e kontratës së publikuar: 275,000.00 €;
- Kriteret e Dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët;
- Afati i fundit për dorëzim është: 02.07.2025 në 14:00 PM;
- Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 22.09.2025;
- Kërkesa për Rishqyrtim pranë AK-së: 26.09.2025;
- Vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga AK-ja: 06.10.2025;
- Vendimi i Organit Shqyrtues së Prokurimit, me nr: 0992/2025 i datës: 12.11.2026;
- Vendimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e njoftimit të dhënies së kontratës: 19.11.2025;
- Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 29.01.2026;
- Letër standarde për tenderusin e eliminuar: 29.01.2026
- Kërkesa për rishqyrtim me: 30.01.2026;
- Vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 09.02.2026;
- Vendimi i Organit Shqyrtues së Prokurimit, me nr: 0092/2026 i datës: 17.03.2026
- Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 21.08.2026.
- Kërkesa për rishqyrtim me: 24.08.2026;
- Vendim mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim: 31.08.2026.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve,

Ne nuk kemi marrë pjesë në procese verbale të hapjesë. Por përmes Platformës e-prokurimi <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>, e kemi pranuar me datë 02.07.2025.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve

Ne kemi pranuar letren për tenderusin e eliminuar në kundërshtime me legjisacionin e LPP-së, pra jemi eliminuar për kërkesa që nuk janë kanë të cekura në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Më datë 21.08.2026, jemi njoftuar nga Autoriteti Kontraktues lidhur me Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letrën Standarde për tenderuesin e eliminuar.

Konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues është i kundërligjshëm dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, për faktin se vlerësimi i bërë nga Autoriteti Kontraktues nuk është në përputhje me vendimet paraprake të Organit Shqyrtues të Prokurimit dhe, për më tepër, kompania jonë është eliminuar mbi bazën e kërkesave të cilat, sipas dokumentacionit të tenderit, nuk kanë qenë të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit.

I. MOSRESPEKTIMI I VENDIMEVE TË OSHP-SË

Në këtë aktivitet të prokurimit, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka nxjerrë dy vendime, përkatësisht:

Vendimin nr. 2025/0992; dhe

Vendimin nr. 2026/0092, të datës 17.03.2026.

Në të dyja këto vendime është konstatuar se operatori ekonomik **Mirsad Gashi B.I.**, i rekomanduar për dhënien e kontratës, është i papërgjegjshëm.

Megjithatë, përkundër këtyre konstatimeve të OSHP-së, Autoriteti Kontraktues përsëri e ka trajtuar dhe vlerësuar operatorin ekonomik Mirsad Gashi B.I. si operator ekonomik të përgjegjshëm dhe ka vazhduar procedurën në favor të tij.

Kjo paraqet një kundërthënie të drejtpërdrejtë ndërmjet konstatimeve të organit kompetent shqyrtues dhe veprimeve të mëvonshme të Autoritetit Kontraktues.

OSHP-ja, në dy vendime të veçanta, ka konstatuar papërgjegjshmërinë e OE-së Mirsad Gashi B.I., Autoriteti Kontraktues e rekomandon për dhënie të kontratës. Autoriteti Kontraktues thjesht të përsërisë vlerësimin e tij të mëparshëm pa adresuar në mënyrë konkrete gjetjet dhe konstatimet e OSHP-së.

II. VEPRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES PARA GJYKATËS ADMINISTRATIVE DHE GJYKATËS SË APELIT

Për më tepër, vetë Autoriteti Kontraktues, duke mos u pajtuar me Vendimin e OSHP-së nr. 2026/0092, të datës 17.03.2026, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Kosovës, duke kërkuar caktimin e masës së sigurisë dhe shtyrjen e ekzekutimit të këtij vendimi. Mirëpo, më datë 28.05.2026, Gjykata Administrative e Kosovës e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e Autoritetit Kontraktues. Gjithashtu, edhe Gjykata e Apelit e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Autoritetit Kontraktues.

Rrjedhimisht, në rrethanat e këtij rasti, Autoriteti Kontraktues anashkalonë vendimit të OSHP-së dhe Gjykatave Administrative dhe të Apelit.

Një shkelje tjetër esenciale që kundërshtojmë është fakti se kompania jonë është eliminuar për shkak të një kërkesë kushti i cili nuk ka qenë i përcaktuar në Njoftimin për Kontratë dhe as në Dosjen e Tenderit.

Autoriteti Kontraktues nuk mund të vendosë pas dorëzimit të ofertave kritere, kërkesa apo kushte të reja të cilat nuk kanë qenë të bëra të ditura paraprakisht për të gjithë operatorët ekonomikë.

Ne si Operatorët ekonomikë, oferta e jonë është mbi bazën e kërkesave të përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit. Për këtë arsye, një operator ekonomik nuk mund të eliminohet për mosplotësimin e një kërkesë e cila nuk ka qenë pjesë e kritereve dhe kërkesave të shpallura paraprakisht.

OSHP-ja me vendimin nr. 2025/0992 ka trajtuar çështjen e përgjegjshmërisë së OE-së Mirsad Gashi B.I.; OSHP-ja me vendimin nr. 2026/0092 përsëri ka konstatuar papërgjegjshmërinë e këtij operatori. Autoriteti Kontraktues e ka dërguar çështjen në Gjykatën Administrative, kërkesa e Autoritetit Kontraktues është refuzuar më 28.05.2026; ankesa e Autoritetit Kontraktues është refuzuar edhe nga Gjykata e Apelit dhe pavarësisht kësaj historie procedurale, Autoriteti Kontraktues përsëri e ka vlerësuar OE-në Mirsad Gashi B.I. si të përgjegjshëm, ndërsa kompaninë tonë e ka eliminuar mbi bazën e një kërkesë që, sipas dokumentacionit të tenderit, nuk ka qenë e përcaktuar paraprakisht në NJF dhe DT. Këto rrethana krijojnë një kontradiktë serioze në procesin e vlerësimit.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmit e më sipër, kërkojmë që të konstatohet se Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe Letra Standarde për tenderuesin e eliminuar, të datës 21.08.2026, janë të pabazuara dhe në kundërshtim me dispozitat e aplikueshme të legjislacionit të prokurimit publik.

Në përfundim, kërkojmë që të anulohet vendimi i kundërshtuar dhe të urdhërohet Autoriteti Kontraktues që procedurën e vlerësimit ta zhvillojë në përputhje me LPP-në, dokumentet e tenderit dhe vendimet përkatëse të OSHP-së dhe gjykatave.

Do të kërkojm nga ana e OSHP-së duke u bazuar në LPP-në Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, paragrafi 3, citon: **Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.**

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Autoriteti Kontraktues- (AK) ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

- Ligjit nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si në vazhdim:
 - Neni 1, i LPP-së Qëllimi;
 - Neni 6, i LPP-së Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
 - Neni 7, i LPP-së Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
 - Neni 59, i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
 - Neni 56, i LPP-së Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, paragrafi 3;
 - Neni 61, i LPP-së Tenderët Jo-Normalisht të Ulët;
 - Neni 60, i LPP-së Kriteret për Dhënien e Kontratës
 - Neni 69, i LPP-së Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale;
- Dispozitat e Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik në tekstin e mëtejshëm do të i referohemi RRPP-së
 - Neni 4, Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit, i Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik;
 - Neni 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, i Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik;
 - Neni 41, Tenderët Jo-normalisht të Ulët i Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik, paragrafin, 41.6,41.8,41.9,41.10.
 - Neni 97, Shkeljet e rënd, pika h. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së
- UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK.
 - Neni 10.1 Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, i UDHËZUES NR. 002/2024.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Kompania **Gani B. Krasniqi B.I- D.P.Z "Suzuki"** me seli në Miradi e Ulët Fushë Kosovë (me tej: Ankuesi), brenda afatit ligjor te paraparë më dispozitën e Sipas *Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës Kosovës*, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, respektivisht, brenda afatit të lënë, paraqet këtë **Ankesë** pasi qe Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në këtë aktivitet te prokurimit ka dorezuar oferta të papërgjegjeshme dhe nuk janë zbatuar vendimet OSHP-së për aktivitetin e prokurimit me **Titull: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së (tenderi është i ndarë në 4 pjesë)**, me nr prokurimit: **11600-25-4483-211**, Nr. i brendshëm prokurimit: **11600-25-014-211**, e inicuar nga Autoriteti Kontraktues-(AK) Administrata Tatimore e Kosovës.

Për këtë aktivitet te prokurimit janë nxjerr dy vendim nga Organi Shqyrtues i Kosovës i datës 12.11.2025 me nr: 2025/0992, dhe 2026/0092 i datës 17/03/2026 permes këtyre vendimeve janë identifikuar shkeljet e AK-së në këtë procedur te prokurimit, dhe është vertetu se OE-ja i rekomanduar për kontratë Mirsad Gashi B.I. është i papërgjegjshëm. Por te njejtin AK-ja e rekomandon perseri për kontratë me datën 21.08.2026.

Lidhur me Letrën Standarde për eliminimin e kompanisë sonë, të datës **21.08.2026**, konsiderojmë se arsyetimi i dhënë nga Autoriteti Kontraktues është i pamjaftueshëm, i paqartë dhe nuk përmbush kërkesat për një vendim të arsyetuar dhe të kuptueshëm. Duke u bazuar në LPP-në **Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, paragrafi 3**, citon: **Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.** Në rastin konkret, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në një procedurë e cila paraprakisht është trajtuar dhe është objekt i dy vendimeve të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), përkatësisht vendimeve nr. **2025/0992** dhe **2026/0092**, si dhe vendimeve të **Gjykatës Administrative** dhe **Gjykatës së Apelit**.

Për këtë arsye, në rrethanat konkrete, Autoriteti Kontraktues në Letrën Standarde të datës 21.08.2026 nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë, konkrete dhe të argumentuar bazën faktike dhe juridike mbi të cilën është marrë vendimi për eliminimin e kompanisë sonë, duke adresuar në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe gjetjet dhe çështjet e trajtuara në vendimet e mëparshme të OSHP-së dhe gjykatave.

Një arsyetim i përgjithshëm, i paqartë, kontradiktor apo që nuk tregon konkretisht se cilat kërkesa të tenderit pretendohet se nuk janë përmbushur, cilat prova janë marrë parasysh dhe përse ato prova çojnë në përfundimin për eliminim, nuk konsiderohet si arsyetim i mjaftueshëm i një vendimi administrativ.

Prandaj, konsiderojmë se Letra Standarde e datës 21.08.2026 nuk ofron një arsyetim të tillë që do t'i mundësonte kompanisë sonë të kuptojë qartë bazën faktike dhe juridike të eliminimit, e aq më pak të ushtrojë në mënyrë efektive të drejtën për mbrojtje dhe mjet juridik.

Veçanërisht duke pasur parasysh historikun e kësaj procedure dhe vendimet paraprake të OSHP-së dhe gjykatave, Autoriteti Kontraktues nuk mund të mjaftohet me një arsyetim formal apo të përgjithshëm, por duhet të japë përgjigje konkrete dhe të argumentuara për çështjet që kanë qenë objekt i shqyrtimit dhe të sqarojë bazën e saktë mbi të cilën ka ardhur në përfundimin për eliminimin e kompanisë sonë. Për rrjedhojë, oferta jonë është plotësisht konform Njoftimit për Kontrat dhe DT-së.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues – ne vendimin me nr. 2025/0992

-Lidhur me pretendimin nr. 2,

PSH, konstaton se Në dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi e hapësirave te objektit te prezantuar nga OE-ja i rekomanduar për kontratë nuk e përmbushë këtë kriter te NJF dhe DT-së, pasi qe nuk ka afruar dëshmi te garte se posedone hapësire për servisim me sipërfaqje prej 250 m2.

-Lidhur me pretendimin nr. 3,

PSH sqaron se duhet cekur faktin se nga përshkrimi i kërkesës ne dosje të tenderit si dëshmi është kërkuar faturë, foto ose dokumentacion tjetër dëshmuës, foto nuk është dëshmia e vetme që është kërkuar dhe që dëshmon se OE i rekomanduar për kontratë a i posedon pajisjet e siç kërkohen ne NJF dhe DT. Andaj duke u mbështetur te fotot e OE-së, sqarojmë se fotografitë e dorëzuara me ofertë për disa pajisje nuk mund të vërtetohet se a janë në pronësi te Operatorit ekonomik te rekomanduar për kontratë dhe ne foto nuk ka ndonjë emërtim te pajisjes.

-Lidhur me pretendimin nr. 5,

AK-ja është dashtë te veproje në përputhje me UDHËZUES NR. 002/2024, Neni 10.1., duke eliminuar pa kërkuar sqarim. Për arsye se kriter ka qenë kërkesa e veçantë në dosje të tenderit, ku është kërkuar që te jetë i nënshkruar dhe vulosur, mungesa e vulës e bënë dokumentin jo të plotë.

-Lidhur me pretendimin nr. 6 ,

Për faktin se OE i rekomanduar për kontratë në ka afruar çmimeve jo reale, ka vendosure çmimi absurde për riparime te pjesëve, ndërsa për ndërrimin e pjesëve qe nënkupton qe duhet te jene te reja dhe origjinale nga prodhuesi ka vendosure çmime jo-normalisht të ulëta, nga kjo nënkuptohet se çmimet e ofruar blerje me riparim nuk janë ne as një rrethanë çmime reale. Paneli Shqyrtues e mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në Rivlerësim, ndërsa ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Faktet dhe rrethanat e aktivitetit te prokurimit:

Me datën 20.05.2025 Autoriteti Kontraktues Administrata Tatimore e Kosovës permes Platformën eprokurimi <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>. ka bërë publike Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit me **Titull: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së (tenderi është i ndarë në 4 pjesë)**, me nr prokurimit: **11600-25-4483-211**, Nr. i brendshëm prokurimit: **11600-25-014-211**.

Autoriteti Kontraktues-(AK) Administrata Tatimore e Kosovës me datë: 22.09.2025, në sistemin e prokurimit elektronik ne platformes e-prokurimit, ne cilësi të tenderuesit pjesëmarrës jemi njoftura me Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues B58 dhe me Letër standarde për tenderuesin e pasuksesshëm.

Me datën 26.09.2025, kemi bërë kërkesë për rishqyrtim, pranë AK-së, me datën 06.10.2025 AK-ja refuzone kërkesën tonë si te pabazuar. Me datën 07.10.2025 pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit kemi bërë ankesë mbi faktet dhe argumentet te cilat i posedojm.

Me datën 12.11.2025 OSHP-ja nxjerr vendimin me nr: me nr: 2025/0992 ku e Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE Gani B. Krasniqi B.I. me nr. 2025/0992, e datës 07/10/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së (tenderi është i ndarë në 4 pjesë) me numër të prokurimit 11600-25-4483-2-1-1., dhe Anulohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK të ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS, ndërkaq aktiviteti i prokurimit Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së (tenderi është i ndarë në 4 pjesë) me numër të prokurimit 11600-25-4483-2- 1-1 kthehet në Rivlerësim.

Me datën 19.11.2025 AK-ja Administrata Tatimore e Kosovës anulon vendimin për dhënies te kontratës ku ishte rekomanduar OE-ja Mirsad Gashi B.I.

Autoriteti Kontraktues Administrata Tatimore e Kosovës me datën 29.01.2026 nxjer Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues B58 ku rekomandon te njejtin OE, Mirsad Gashi B.I. i cili me vendimin e OSHP-së me nr: 2025/0992 të datës 12.11.2025, është OE është i papërgjegjshëm.

Po ashtu me datë 21.08.2026 nxjer Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues B58 ku rekomandon te njejtin OE, Mirsad Gashi B.I. i cili me vendimin e OSHP-së me nr: 2025/0992 dhe me nr: 2026/0092 , është OE është i papërgjegjshëm.

Duke u bazuar në ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe vendimet e OSHP-së Autoriteti Kontraktues-(AK) Administrata Tatimore e Kosovës nuk e ka respektuar Ligjin e Prokurimit Publik dhe RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIM PUBLIK dhe vlersojmë që nuk është bërë vlersimi konform kërkesave të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Duke u bazuar në dokumentat të cilat i kemi siguruar, dhe duke e marre parasyshe se jemi konkurent me OE-në e rekomanduar për kontratë në Institucionet e Republikës së Kosovës, dhe pase vendimit të OSHP-së kemi konstatuar dhe kemi argumente se OE-ja i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm.

Ne vazhdim po ju njohim me faktet dhe argumentet e ofruara që i mbështesin pretendimet tona për të cilat e bëjnë të **PAPËRGJEGJSHËM** Operatorin ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe shkeljet e dispozitave të LPP-së nga vete e Autoriteti Kontraktues;

Pasi që ne vendimin 2026/0092 Panelti Shqyrtues pran Organit Shqyrtues të Prokurimit i ka lëshuar vërejtje ndaj zyrtarit përgjegjës të prokurimit. Kërkojm nga ana e Panelti Shqyrtues pran Organit Shqyrtues të Prokurimit, duke u bazuar në LPP në dhe RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Neni 97 Shkeljet e rënda, pika h. Mos respektimi i vendimeve të OSHP-së dhe KRPP-së të inicoje kërkesën e revokimit të çertifikatës profesionale të prokurimit pran Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik Për zyrtarin përgjegjës të prokurimit pran AK-së Administrates Tatimore të Kosovës, për këto arsye;

1. Nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP-së me nr: 2025/0992 të datës 12.11.2025. Operatorin Ekonomik i cili sipas vendimit është i papërgjegjshëm me datën 28.08.2026 per heren e tretë e ka rekomanduar për kontratë. Ne vendimin e datës 12.11.2025 një nder pretendimet ankimore te kompanis tonë PSH, konstatone. **Gjithashtu PSH sqaron se AK-ja nuk mund ti kërkoje sqarim lidhur me vulën duke u bazuar ne nenin 59 paragrafi 4 i LPP-së dhe nenin 72 paragrafi 2 dhe 3. AK-ja është dashtë te veproje në përputhje me UDHËZUES NR. 002/2024, Neni 10.1., duke eliminuar pa kërkuar sqarim. Për arsyje se kriter ka genë kërkesa e veçantë në dosje të tenderit, ku është kërkuar që te jetë i nënshkruar dhe vulosur, mungesa e vulës e bënë dokumentin jo të plotë.**
2. Nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP-së me nr: 2026/0092 i datës 17/03/2026 Operatorin Ekonomik i cili sipas vendimit është i papërgjegjshëm.
3. Me datën 20.10.2025 permese Platformës e-prokurimi <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>, (jyzerit) te Autoritetit Kontraktues ATK-së ngarkone dokumentat e OE-së te rekomanduar për kontratë OE-së Mirsad Gashi B.I., i cili ka bërë kundërshtimin në raportin e Ekspertizës. Te njejtin dokument te OE- së rekomandur ngarkone ne Platformën eprokurimi pas as një autorizim. Për këtë qështje do drejtohem i edhe organeve te Drejtsisë.

Dërguar nga : ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

AK përgjigja për të raportuar

kundershtim i raportit te ekspertit_2025-0992.pdf

20.10.2025 16:10

Hape:

 Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip



Dërguar nga : ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

AK përgjigja për të raportuar

Parashtrese-Kundershtim i Raportit te Ekspertizes te
dt.14.10.2025.pdf

20.10.2025 16:13

Hape:

 Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip



➤ Pretendimin ankimor nr. 1:

Lidhure me pretendimet mbi eliminimin tonë në këtë aktivitet te prokurimit, janë të janë të pa sakta, një vendim i till për eliminimin tonë është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij. Të gjitha dokumentat të dorzuar nga kompania jonë në këtë aktivitet te prokurimit, në ofertën e datës 02.07.2025, janë të nënshkruar dhe vulosur nga pronari i kompanin z. Gani Krasniqi. Të njejtat dokumenta në këtë procedur te prokurimit janë ngarkuar nga webfaqja e eprokurimit Platformën eprokurimi <https://e-prokurimi.rks-gov.net/> te kompanis **Gani B. Krasniqi B.I.D.P.Z "Suzuki"**. Po ashtu të gjitha dokumenta tjera të dorzuar në këtë procedur janë nënshkruar dhe volusr vetem nga pronari i kompanis. Deklarat nën betim është e nënshkruar nga pronari i kompanis dhe secili dokument tjetër i dorzuar për këtë aktivitet te prokurimit.

Lidhur me pretendimin tjetër për eliminimin tonë, se ne kemi dorzuar dokumente-oferta pa autorizime,ky pretendim është qesharak, për këtë arsye; Në Dosjen e Tenderit te Aneksi 1. Te SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME ju si Autoritet Kontraktues keni kërkuar si në vijim: **Pjesët që ndërrohen kërkohet të jenë origjinale, të reja, të paketuara, ambalazhuara nga prodhuesi.**

Me datën 27.05.2025 permes Platformën eprokurimi <https://e-prokurimi.rks-gov.net/>, ju si Autoritet Kontraktues keni ngarkuar Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit dhe jeni përgjigjur si me poshtë;

Përgjigje 1 nga njësia kërkuese në AK: 8 vetura, lloji: Skoda Octavia Ambition 2.0 TDI Evo / DSG/ 150, janë me vit të prodhimit 2023, vëllimi i motorit 1968 ccm, si mostër një numër i shasisë së veturës është TMBAJ8NX1RY084088, karoserija: limuzinë; 20 vetura, lloji: Skoda Octavia FL Selection 2.0 TDI Evo /DSG/ 150hp, janë me vit të prodhimit 2025, vëllimi i motorit 1968 ccm, si mostër një numër i shasisë së veturës është TMBAJ8NX1SM022042, karoserija: limuzinë; 1 veturë, lloji: Skoda Superb NG Essence 2.0 TDI DSG 150hp, është me vit të prodhimit 2025, vëllimi i motorit 1968 ccm, numri i shasisë së veturës TMBAH8NZ2SC030489, karoserija: limuzinë.

Për pjesën 3 për llojin e veturave VW Golf 1.9 TDI, janë me vit të prodhimit 2022, si mostër një numër i shasisë së veturës është WVWZZZ1JZ3D015227, karoserija: karavan.

Për pjesën 2 për llojin e veturave Peugeot 308 style 1.5, kw 96, janë 58 vetura, vëllimi i motorit është 1499 ccm, automjet për pasagjer, si mostër një numër i shasisë së veturës është VR3FBYHZXRY605923

Të dhënat me specifika teknike mbesin të pandryshuara siç është kërkuar në aneksin 1 të specifikimeve në dosjen e tenderit.

Autoritet Kontraktues ka ngarkuar Numrin e shasise për këto automjetet. Duke u bazuar në automjetet që janë të viti të prodhimit 2020 dhe 2025 dhe kërkesave të Dosjes së Tenderit të Pjesët që ndërrohen kërkohet të jenë origjinale, të reja, të paketuara, ambalazhuara nga prodhuesi. Është vetëm një kompani në Republikën e Kosovës i autorizuar nga prodhuesi. Në bazë të këtyre dëshmive në kemi marrë oferta.

➤ Pretendimin ankimor nr. 2;

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, kërkesa me Nr.3: është kërkuar.

Kërkesa 3: Hapësira e objektit të servisit kërkohet të jetë minimum 250 m² me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi ose kontrata për marrje me qira për të cilën duhet të dëshmoj me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi nga qiradhënësi. Kjo hapësirë duhet të jetë e mbyllur dhe e mbrojtur nga ndikimet e faktorëve të jashtëm, siç janë: reshjet, era, pluhuri. Hapësira e objektit të servisit, duhet të jetë larg në rrugë tokësore maksimumi deri 15 kilometra me pikë referimi nga ndërtesa e Objektit të AK-së me adresë: Bulevardi: Dëshmorët e Kombit & Bill Clinton, Prishtinë. (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Dokumentet dëshmuese për mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Evidenca 3: Hapësira e objektit të servisit, të dëshmohet me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi ose kontrata për marrje me qira për të cilën duhet të dëshmoj me dokumentacion përkatës zyrtar për pronësi nga qiradhënësi. Hapësira e objektit të servisit, të dëshmohet me dëshmi me shkrim mbi vendndodhjen dhe largësin e servisit në rrugë tokësore maksimumi deri 15 kilometra me pikë referimi nga ndërtesa e Objektit të AK-së me adresë, Bulevardi: Dëshmorët e Kombit & Bill Clinton, Prishtinë (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Duke u bazuar në OE-në e rekomanduar për kontratë Mirsad Gashi B.I., dhe marrë parasysh se jemi konkurent me OE-në në Institucionet e Republikës së Kosovës, dhe marrim pjesë në aktivitete të njëjta të prokurimit për servise dhe mirëmbajtje të automjeteve kemi konstatuar se OE nuk posedon hapësirë të objektit të servisit prej 250 m². OE-ja Mirsad Gashi B.I. në aktivitete të prokurimit prezanton një dokument Leje të Objektit me një sipërfaqe prej 250 m². Objekti përfshijë dy pjesë të objektit të servisit, 8x10=80m², dhe 8x10=80m², ku gjithsej bëjnë 160m² hapësirë të objektit të servisit të automjeteve. Një pjesë të objektit të posedon depo për autopjesë, ku besojë dëshmohet edhe me foto të prezantuara nga vete OE-ja. Dhe nga i njëjti objekt është një pjesë zyre, dhe kafe e cila shërben për nevojat e OE-së. OE-ja i rekomanduar për kontratë nuk posedon Hapësirë të Objektit të servisit prej 250 m². OE-ja të AK-ja ka prezantuar dokumente objektit prej 250 m² por në të njëjtin objekt janë të përfshirë edhe hapësira për shitjen e autopjesëve, hapësira e zyreve, dhe hapësira e quajture kafe për nevojat e servisit. Oferta e dorëzuar nga OE-ja i rekomanduar për kontratë nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Në atë hapësirë të ofruar prej 250m², janë të përfshirë dy pjesë të objektit të servisit për servise, depoja, zyrja etj. AK-ja përmes fotove të dorëzuara mund të verifikon. Po ashtu kërkojmë nga AK-ja, ATK, duke u bazuar në nenin 59 komisioni i vlersimit të bëjë një vizitë të OE-ja i rekomanduar për kontratë dhe të argumentojë pretendimet tona ankimore në lidhje me Hapësirë të objektit të OE-së rekomanduar për kontratë. Gjithashtu në vendimin e AK-së të kërkesës për rishqyrtim, të kompanisë tonë, të na dëshmojë me fotografi se si duket hapësira e OE-së. **Prova: Vendimin e OSHP-së, (e njëjta hapësirë mund të shihet edhe përmes googel mapsit).**

➤ Pretendimin ankimor nr. 3;

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), të Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, kërkesa me Nr.4: është kërkuar.

Kërkesa 4: Dëshmi mbi disponimin e mjeteve apo pajisjet teknike në dispozicion: Vinç hidraulik për ngritjen e automjeteve – së paku 4 (katër) vinça; Pajisje speciale (kompjuteristike) për diagnostifikimin e defekteve të automjeteve – së paku 1 (një); Pajisje për vullkanizim dhe balansim të gomave – së paku 1 (një); Pajisje për mbushjen e klimave të automjeteve – së paku 1 (një). (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Dokumentet dëshmuese për mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Evidenca 4: Paisjet e kërkuara të dëshmohen me faturë, foto, ose dokumentacion tjetër dëshmues mbi pronësinë (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Duke u bazuar ne OE-në e rekomanduar për kontratë Mirsad Gashi B.I., dhe marre parasyshe se jemi konkurent me OE-në në Institucionet e Republikës së Kosovës, dhe marrim pjesë ne aktivitete e njejta te prokurimit për servise dhe mirëmbajtje te automjeteve supozojem se nuk posedone ne disponim mjetet pajisjet teknike, dhe nuk ka arritur që ti dëshmoje AK-së me dokumenta dëshmuese pajisjet e kërkuara, vinç hidraulik për ngritjen e automjeteve, Pajisje speciale kompjuteristike për diagnostifikimin e defekteve, pajisje për vullkanizim dhe balansim të gomave, pajisje për mbushjen e klimave të automjeteve. Për te njejtat pajisje teknike OE-ja i rekomanduar për kontratë nuk posedon ndonje dëshmi fatur ose dokumentacione dëshmues qe i posedone ne pronsi. OE-ja perpos fotos nuk posedone as një dëshmi tjeter dëshmues mbi dëshimin e mjeteve dhe pajisjeve. Fotografia nuk është dokument dëshmus, në NJF dhe DT, AK-ja ka kërkuar ku citohet; ***Dëshmi mbi disponimin e mjeteve apo pajisjet teknike në dispozicion.***

Prova: Vendimin e OSHP-së, (foto nuk janë dëshmi e posedimit te pajisjeve).

Prova: Vendimin e OSHP-së

➤ Pretendimin ankimor nr. 4;

Në Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 &9.2, kërkesa me Nr.6: është kërkuar.

Kërkesa 6: Deklaratë me shkrim për shërbimet, mallrat e ofruara të cilat do të janë në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Dokumentet dëshmuese për mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Evidenca 6: Të dorëzohet deklarata me shkrim e nënshkruar dhe **vulosur** nga OE për shërbimet, mallrat e ofruara të cilat do të janë në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (kërkohet për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4).

Me data: 23.09.2025, kur na është lejuar qasja ne dokumentacionin e Operatorit ekonomik (OE)-së të rekomanduar për kontratë Mirsad Gashi B.I., kemi marre edhe deklaraten dhënë nga OE-ja, për kryrjen e shërbimeve në pajtushmeri me specifikacionin teknike te kërkuar në NJF dhe DT. Deklarat nuk është e vulosure nga OE-ja i rekomanduar për kontratë, deklarata është vetem e nënshkruar. Kërkesa me nr 6 në FDT ka qenë që duhet te dorëzohet deklarata me shkrime e nënshkruar dhe vulosure nga OE. Deklarat e shërbimeve te cilene ne e posedojme nga OE-ja i rekomanduar nuk është e vulosur, dhe i mungone vula, sipase kërkesave te para para në NJF dhe DT. Në këtë raste duke u bazuar në UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, AK-ja është dashtë të refuzohet tenderin pa kërkuar informacion shtese të mëtejshëm, sepse është kusht administrativ. Ku e percaktone Neni 10.1. i UDHËZUES.

Me vendimin e OSHP-së me nr: 2025/0992 të datës 12.11.2025. 1. PSH, konstatone. **Gjithashtu PSH sqaron se AK-ja nuk mund ti kërkoje sqarim lidhur me vulën duke u bazuar ne nenin 59 paragrafi 4 i LPP-së dhe nenin 72 paragrafi 2 dhe 3. AK-ja është dashtë te veproje në përputhje me UDHËZUES NR. 002/2024, Neni 10.1., duke eliminuar pa kërkuar sqarim. Për arsye se kriter ka qenë kërkesa e veçantë në dosje të tenderit, ku është kërkuar që te jetë i nënshkruar dhe vulosur, mungesa e vulës e bënë dokumentin jo të plotë.**

Dokumentin i cili nuk mund te kërkohet në baze te nenit 59 dhe 72 te LPP-së. AK e konsiderin si gabim teknik te vogel.

Emri i AK: ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së (tenderi është i ndarë në 4 pjesë)**

Nr. I Prokurimit	11600-25-4483-2-1-1
------------------	---------------------

DEKLARATË
për kryerjen e shërbimeve në pajtueshmëri me specifikacionin teknik-Listat e çmimeve, me ato të përmendura në Aneksin 1 të DT

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: **Mirsad Gashi B.I. (N.T.P. "MIRI")** deklaroj se jam i përshtatshëm në përputhje me **Nenin 69**, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë të **Nenit 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale** dhe vërtetoj se i përmbush këto kërkesa për pjesëmarrje në këtë procedure te prokurimit- Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1.& 9.2, poashtu

Deklarojmë se mallrat e ofruara do të jenë në përputhje me specifikacionet teknike të kërkuara në Aneksin 1 të dosjes së tenderit (për pjesën 1, pjesën 2, pjesën 3, pjesën 4). Deklarojmë se shërbimet Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare sipas kërkesave të AK-së (tenderi është i ndarë në 4 pjesë) do të kryehen në përputhje me specifikacionin teknik, me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit dhe Listen e çmimeve.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	Mirsad Gashi B.I. (N.T.P. "MIRI")
Adresa e plotë:	Prishtinë
I përfaqësuar nga:	
Emri	Mirsad Gashi
Pozita	Drejtor
Nënshkrimi	
Data	02.07.2025
Vula	

Prova: Vendimin e OSHP-së

➤ **Pretendimin ankimor nr. 5;**

Autoriteti Kontraktues ka bërë bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët te LPP-së, Neni 41

Tenderët Jo-normalisht të Ulët, të RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, pasi që OE-ja i rekomanduar për kontratë ka

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME		
Pjesët	<u>Pjesa 1: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare, lloji: Skoda Octavia</u> • 28 vetura Skoda Octavia me kapacitet të vëllimit 1968 ccm, lloji: limuzin 5 dyer, numri i ulsëve 5, viti i prodhimit 2023 dhe 2025; • 1 veturë - Skoda superb 2.0 TDI Dsg, kapaciteti i vëllimit 1968 ccm, lloji: limuzin 5 dyer, numri i ulsëve 5, viti i prodhimit 2025; • 1 veturë - Seat, kapaciteti i vëllimit 1968 ccm, lloji: xhip 5 dyer, numri i ulsëve 5, viti i prodhimit 2020; • 1 veturë - Opel, kapaciteti i vëllimit 1499 ccm, lloji: furgon 4 dyer, numri i ulsëve 2, viti i prodhimit 2020; • 1 veturë - Volkswagen, kapaciteti i vëllimit 1498 ccm, lloji: xhip 5 dyer, numri i ulsëve 5, viti i prodhimit 2020. <u>Pjesa 2: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare, lloji: Peugeot 308</u> • 58 vetura - Peugeot 308, kapaciteti i vëllimit 1499 ccm, lloji: veturë 5 dyer, numri i ulsëve 5, viti i prodhimit 2024; • 1 veturë - Peugeot 3008 GT 2.0 BlueHDi 180 KF EAT8, kapaciteti i vëllimit 1997 ccm, lloji: SUV 5 dyer, numri i ulsëve 5, viti i prodhimit 2018; • 1 veturë - Renault, kapaciteti i vëllimit 1461 ccm, lloji: xhip 5 dyer, numri i ulsëve 5, viti i prodhimit 2020; • 1 veturë - Renault, kapaciteti i vëllimit 1332 ccm, lloji: limuzin 5 dyer, numri i ulsëve 5, viti i prodhimit 2020; <u>Pjesa 3: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare, lloji: Golf 4 variant 1.9 TDI 4 motion</u> • 20 vetura - Volkswagen-VW Golf variant 1.9 TDI 4 motion, kapaciteti i vëllimit 1896, limuzin 5 dyer, diesel, viti i prodhimit 2002. <u>Pjesa 4: Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave zyrtare, lloji: Nissan Patrol</u> • 11 vetura - Nissan Patrol GL 3.0 TDI STW, kapaciteti i vëllimit 2953, xhip 5 dyer, viti i prodhimit 2008; • 2 vetura - Nissan Pathfinder, kapaciteti i vëllimit 2488 ccm, lloji: xhip 5 dyer, numri i ulsëve 7, viti i prodhimit 2008.	AK'
1,2,3,4	Servisimi i rregullt e automjeteve dhe pjesë mekanike Te Pjesa C: Pjesa II. Lista e çmimeve-oferta financiare të dosjes së tenderit Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e automjeteve duhet të behet sipas kërkesave dhe nevojave nga Menaxheri i Projektit pranë AK-së. Në çmim për çdo pozicion duhet të llogaritet çmimi i pjesës (ÇP) dhe çmimi i shërbimit (ÇSH) për secilin pozicion për furnizim, shërbim që është përshkruar te Pjesa C Pjesa II. Lista e çmimeve te oferta financiare të dosjes së tenderit. Në çdo fushë kërkohet të vendosni, shënoni çmimet në të kundërtën oferta e juaj nuk do të vlerësohet dhe do të vlerësohet e papërgjegjshme. Pjesët që ndërrohen kërkohet të jenë origjinale, të reja, të paketuara, ambalazhuara nga prodhuesi. Garancioni kërkohet siç është kërkuar për çdo pozicion te Pjesa C: Pjesa II. Lista e çmimeve te oferta financiare. Pjesët mekanike dhe elektrike Te Pjesa C: Pjesa II. Lista e çmimeve te oferta financiare të dosjes së tenderit Servisimi dhe mirëmbajtja e për pjesët mekanike dhe elektrike rregullt duhet të behet sipas kërkesave dhe nevojave nga Menaxheri i Projektit pranë AK-së.	

Në çmim për çdo pozicion duhet të llogaritet çmimi i pjesës (ÇP) dhe çmimi i shërbimit (ÇSH) për secilin pozicion për furnizim, shërbim që është përshkruar te Pjesa C Lista e çmimeve-oferta financiare të dosjes së tenderit.

Në çdo fushë vendosni çmimet në të kundërtën oferta e juaj nuk do të vlerësohet dhe do të vlerësohet e papërgjegjshme. **Pjesët që ndërrohen kërkohet të jenë origjinale, të reja, të paketuara, ambalazhuara nga prodhuesi.** Garancioni kërkohet siç është kërkuar për çdo pozicion te Pjesa C: Pjesa II. Lista e çmimeve te oferta financiare.

Riparimi i pjesëve të limarisë dhe ngjyrosja

Te Pjesa C: Pjesa II. Lista e çmimeve te oferta financiare të dosjes së tenderit

Riparimi i pjesëve të limarisë dhe ngjyrosja duhet të behet sipas kërkesave dhe nevojave nga Menaxheri i Projektit pranë AK-së.

Në çmimin e riparimit te pjesëve të limarisë së veturës duhet të llogariten riparimi i pjesëve të limarisë, puna, montimi, ngjyrosja si dhe te gjitha shpenzimet tjera që lindin si rezultat i riparimit te pjesëve të limarisë së automjetit siç janë përshkruar pozicionet te Pjesa II. Lista e çmimeve te oferta financiare.

Në çmim për çdo pozicion duhet të llogaritet çmimi i pjesës (ÇP) dhe çmimi i shërbimit (ÇSH) për secilin pozicion për furnizim, shërbim që është përshkruar te Pjesa C Lista e çmimeve-oferta financiare të dosjes së tenderit.

Në çdo fushë vendosni çmimet në të kundërtën oferta e juaj nuk do të vlerësohet dhe do të vlerësohet e papërgjegjshme. Garancioni kërkohet siç është kërkuar për çdo pozicion te Pjesa C: Pjesa II. Lista e çmimeve.

Riparim i Pjesëve mekanike dhe elektrike

Te Pjesa C: Pjesa II. Lista e çmimeve te oferta financiare të dosjes së tenderit

Riparimi i pjesëve të mekanike, elektrike duhet të behet sipas kërkesave dhe nevojave nga Menaxheri i Projektit pranë AK-së.

Në çmimin e riparimit te pjesëve mekanike, elektrike dhe riparimit te motorit duhet të llogariten riparimi i pjesëve, puna, montimi, furnizimi me pjesë si dhe te gjitha shpenzimet tjera që lindin si rezultat i riparimit te pjesëve mekanike, elektrike dhe riparimit te motorit siç janë përshkruar pozicionet te Pjesa II. Lista e çmimeve te oferta financiare.

Në çmim për çdo pozicion duhet të llogaritet çmimi i pjesës (ÇP) dhe çmimi i shërbimit (ÇSH) për secilin pozicion për furnizim, shërbim që është përshkruar te Pjesa C Lista e çmimeve-oferta financiare të dosjes së tenderit.

Në çdo fushë vendosni çmimet në të kundërtën oferta e juaj nuk do të vlerësohet dhe do të vlerësohet e papërgjegjshme. Garancioni kërkohet siç është kërkuar për çdo pozicion te Pjesa C: Pjesa II. Lista e çmimeve.

Duke u bazuar në dosjen e tenderit, ne si kompani para dorzimit te ofertave-tenderit kemi marrë oferten e çmimeve për automjetet e cekuar te Pjesa 1, nga PORSCHE PRISHTINA. Pasi që automjetet janë të prodhimit Volsvagen, viti i prodhimit është 2020-2025, dhe në FTD, ka qene kriter i qarte se pjesët duhet te jene nga prodhuesi. Oferta jonë e dorzuar financiare Pjesen 1: lloji Skoda Octavia, te Pjesa II. Lista e çmimeve, është ofert vetëm sipas kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe që i përgjigjete kërkesave te AK-së në FDT.

Operatori e ekonomik i rekomanduar për kontratë te Pjesen 1: lloji Skoda Octavia, te Pjesa II. Lista e çmimeve, ka vendosure çmimeve jo-normalisht te ulët, dhe jashtë çdo normale. Me data: 23.09.2025, na eshte lejuar qasja ne dokumentacionin e Operatorit ekonomik (OE)-së të rekomanduar për kontratë Mirsad Gashi B.I., dhe AK-ja nuk na ka prezentuar ndonjë dokument dëshmuës apo ndonje korrespondencat me OE-në e rekomanduar për kontratë, duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi për tenderin Jo-normalisht të Ulët, në përputhje me Nenin 61 te LPP-së, dhe Rregullores Nr. 001/2022 Për Prokurim Publik në tekstin e mëtejme do të i referohemi RRPP-së, Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët.

Operatori Ekonomik (OE) i rekomanduar për kontratë ka vendosure çmimi Jo-normalisht të Ulët, çmime jo të besueshëm, dhe çmime spekulative, çmime jo tregut në krahasim me specifikat dhe kushtet e kontratës për Pjesa 1:

Servisimi (lloji: Skoda Octavia), Pjesa 2: (lloji: Peugeot 308), Pjesa 3: (lloji: VW Golf IV variant,TDI) Pjesa 4: (lloji: Nissan Patroll).

Me datën 27 maj 2025, AK-ja Administrata Tatimore e Kosovës përmes Platformës eprokurimi <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, bënë sqarimin e tenderit me informata sqaruese për llojet e automjeteve, ku për tri pjesët-llojet si mostër për automjetet ngarkone në sistem me sqarim nr e shasisë, në baze të sqarimit nga AK-ja, me nr shasisë se automjeteve në kemi marrë ofertat e çmimeve nga distrubtorët e autorizuar të prodhuesve, sqarimi për disa pjesë për Pjesën 1: lloji i automjeteve; Skoda Octavia, duke e pasur parasysh kërkesat e percaktuar në FDT nga ana e AK-së. Në ofertat tona të cilat i kemi marrë nga përfaqësuesit e autorizuar të prodhuesve, për Pjesën 1; Skoda Octavia, nga Porche Prishtina, Baki Automobile, në oferta janë të shkruar edhe nr e shasisë se automjeteve të AK-së Administrata Tatimore e Kosovës.

Për Pjesën 1: lloji i automjeteve; Skoda Octavia, OE-ja i rekomanduar ka vendosur çmime normalisht të Ulët, çmime spekulative, në shumicën e pozicioneve. Te emërtimi i pjesëve apo shërbimit disa nga pjesët kryesore ku janë me çmime jashtë cdo normales.

	A	C	D	H = D*G
Nr.	Emërtimi i pjesës apo shërbimit	Njësia matëse	Sasia	Çmimi Total për njësi me TVSH €
1	Dizne elektrike	copë	1	289.00
2	Amortizatori- parë	copë	1	12.25
3	Amortizatori - mbrapa	copë	1	13.00
4	Alternatori (Dinama)	copë	1	11.99
5	Boshpumpa	copë	1	41.99
6	Cilinder i frenimit-rrotës mramë	copë	1	23.39
